



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

UNIVERSITETI I PRISHTINËS – FAKULTETI I MJEKËSISË

RAPORT I MONITORIMIT

30.05.2023, Prishtinë

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për procedurën e monitorimit:

- *Naim Gashi, Drejtor i AKA;*
- *Ilirijana Ademaj Ahmeti, Zyrtare e Lartë për Vlerësim dhe Monitorim, AKA;*
- *Mirlinda Xhylani, Prkatikante në AKA.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 23.05.2023

Monitorimi është realizuar: a) në distancë
b) me vizitë në terren me paralajmërim
c) me vizitë në terren pa paralajmërim

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 23.05.2023

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- Z. Denis Raka, Koordinator për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Mjekësisë;
- Z. Valon Krasniqi, Prodekan i Fakultetit të Mjekësisë.

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Orari i ligjëratave dhe punës praktike;*
- *Listat e pjesëmarrësve të studentëve;*
- *Intervista me profesorë dhe studentë.*

2. Përshkrim i shkurtër i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese në Fakultetin e Mjekësisë filloi në orën 13:00, në departamentin e Farmacisë dhe Stomatologjisë.

Gjate vizitës, ekipi monitorues u takua me Denis Raka, koordinator për sigurimin e cilësisë dhe Valon Krasniqi prodekan në Fakultetin e Mjekësisë. Stafit përgjegjës ishin në dispozicion për të ofruar sqarime dhe përgjigje ndaj kërkesave të ekipit monitorues.

Ekipi monitorues fillimisht paraqiti kërkesë për dëshmi lidhur me mbarëvajtjen e mësimit me metodën e rastin në programet:

1. Mjekësi e Përgjithshme;
2. Farmaci; dhe
3. Stomatologji.

Ekipi monitorues verifikoi mbarëvajtjen e mësimit në përputhje me orarin e ligjëratave (dhe ushtrimeve) duke u bazuar në shpalljet e orareve të ligjëratave në panot përkatëse të publikuara brenda hapësirave të fakultetit të mjekësisë. Gjatë verifikimit, ekipi monitorues konstatoi se në të gjitha ambientet e mësimit ishin prezent mësime dhe studentët e prezantuar sipas listës së orareve dhe ligjëratave.

Në vazhdim të vizitës monitoruese, ekipi ka verifikuar ligjëratat në ambientet gjatë mësimeve në programin e "Farmacisë" në lëndët "Shkathtësitë e komunikimit në Farmaci", "Teknologji e Farmacisë" dhe "Bazat e Teknologjisë" të ligjëruar nga prof. Adnan Bozalia, prof. Arlinda Daka dhe prof. Aida Loshi.

Më tutje, ekipi monitorues ka verifikuar ligjëratat në ambientet e mësimeve në programin e "Mjekësisë së Përgjithshme" me lëndën "Farmakologji me Toksikologji" e ligjëruar nga prof. Elton Bahtiri.

Gjithashtu, ekipi ka verifikuar ligjëratat në ambientet gjatë mësimeve në programin e Stomatologjisë me lëndët "Mjekësi orale" (ushtrime) dhe "Paradontologji" të ligjëruar nga prof. Fatmir Dragidella dhe prof. Saranda Disha Ibrahimimi.

Ambientet e hapësirave të departamentit të stomatologjisë u prezantuan edhe nga drejtori i klinikës së stomatologjisë prof. Agim Begzati me të cilin ekipi monitorues bashkëbisedoi lidhur me punën praktike dhe mësimeve në këtë klinikë.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

1. Ekipi monitorues ka konstatuar se mbarëvajtja e ligjëratave dhe punës praktike ka qenë në përputhje me oraret.
2. Ekipi monitorues nuk ka pranuar dëshmi mbi evidencën dhe pjesëmarrjen e studentëve, pasi që nga ekipi i Fakultetit të Mjekësisë është thënë që ato procedohen në fund të çdo muaji.

3. Ekipi monitorues nuk ka pranuar dëshmi mbi evidencën dhe pjesëmarrjen e mësimdhënësve pasi që nga përfaqësuesit e Fakultetit të Mjekësisë është thënë që sistemi i evidencave nuk është në funksion.

4. SHTOJCAT (nëse aplikohet)

1.

Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së

Kryesues

NAIM GASHI [Signature]
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

ILIRJANE ADEKAJ AHMETI [Signature]
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Mirlindë Gashi-Xhylami [Signature]
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)